



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 912/1 prot.

Tiranë, më 14.06.2022

V E N D I M

Nr. 120, Datë 14.06.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 235, datë 17.12.2021, të V.K kundër Bashkisë Klos, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹” dhe “gjendjes arsimore²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Kam filluar punë pranë Bashkisë Klos, me datë 07.05.2017 si specialist auditi. Me datë 15.11.2019 më janë shkëputur marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me Bashkinë Klos, nëpërmjet dorëheqjes si nëpunës civil, nga pozicioni i Përgjegjës të Auditit, për shkak të ristrukturimit. Bashkia Klos ka shpallur në faqen e internetit “Njoftim për vend të lirë pune”, për pozicionin e “Përgjegjës të Sektorit të Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë” dhe “Përgjegjës të Zyrës së Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile”. Me anë të shërbimit postar kam paraqitur aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar për këto pozicione për procedurën e lëvizjes paralele e ngritjen në detyrë dhe procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil. Jam informuar se Bashkia Klos, më ka skualifikuar nga procedura e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për shkak se nuk plotësoj kriterin e përcaktuar në nenin 26/3/b, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin

¹ Referuar Vërtetimit nr. 62, datë 07.12.2020 të lëshuar nga Partia Demokratike, Dega Mat, vërtetohet se V.K është anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike dhe në zgjedhjet e vitit 2021 ka qenë anëtar i KZAZ nr. 17, Klos.

² Ankuesi me e-mail-in datë 12.05.2022, pretendon diskriminim edhe për shkak të gjendjes arsimore.

civil”, se nuk jeni nëpunës civil i konfirmuar. Vendimi për skualifikimin tim nga procedura e konkurimit është bërë për arsye të diskriminimit për shkak të bindjes politike, pasi marrëdhëniet e mia të mëparshme të punës në Bashkinë Klos kanë qenë në kohën kur bashkia drejtohej nga subjekti i zgjedhur nga radhët e Partisë Demokratike, ndërsa tani kjo bashki drejtohet nga subjekti i zgjedhur nga Partia Socialiste. Skualifikimi im nga procedura e lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë si “përgjegjës i arsimit” ka patur si qëllim emërimin në këtë pozicion të I.K, e cila është shpallur fituese për këtë pozicion, ndërkohë që unë isha i vetmi kandidat që plotësonte kriteret. Bashkia Klos prej kohësh kishte punësuar “de facto” në këtë pozicion pune edhe pse jo “de jure”, kandidaten tjetër, e cila tashmë është emëruar në këtë pozicion. Anëtarët e Komisionit kanë patur udhëzim për diskriminim nga titullari i institucionit për të përzgjedhur kandidaten e shpallur fituese. Në lidhje me bindjet politike, dua të sqaroj se jam anëtar i PD-së dhe anëtar i kryesisë së PD, Dega Mat. Gjithashtu në zgjedhjet e vitit 2021 kam qenë komisioner i Komisionit Zonal nr. 17 Klos, ku kam përfaqësuar subjektin politik PD. Gjithashtu, anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe ato të ngritjes në detyrë janë anëtarë të PS, ku Drejtori i Burimeve Njerëzore ka qenë përfaqësues i PS në komisionet zgjedhore të zgjedhjeve 2021 dhe Sekretari i Përgjithshëm ka qenë përfaqësues i PS në komisionin e zgjedhjeve të vitit 2021 dhe Drejtori i DZHT ka qenë anëtar i PS në komisionin e zgjedhjeve vendore 2019”.

Gjithashtu, në ankesën e tij V.K pretendon se: “Më datë 06.12.2019, Bashkia Klos është vënë në dijeni të shkresës nr. 1625/2, datë 03.11.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me lëndë “Dërgohet vendimi paralajmërues nr. 150, datë 03.11.2019 i KMSHC” ku ndër të tjera citohet: “...kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Klos me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, 32 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil dhe të rregullojë pasojat për punonjësit...”. Referuar vendimit të sipërcituar të KMSHC-së, evidentohet se ndër 32 personat e emëruar në shkelje të legjislacionit “Për nëpunësin civil”, është dhe V.K me detyrë Përgjegjës i Auditit të Brendshëm në Bashkinë Klos. Në vijim, Bashkia Klos në mbështetje të detyrimeve të lëna nga KMSHC, ka zbatuar vendimin, duke ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me të gjithë punonjësit (32) e emëruar në kundërshtim me ligjin. Vendimi i KMSHC është zbatuar me dy standarte. Nga ana e Bashkisë Klos janë emëruar në janar 2020, dy punonjës në sektorin e auditit pa procedurë konkurimi, pa u shpallur vendet vakante dhe nuk jam njoftuar unë që kam qenë në këtë pozicion pune dhe plotësoj të gjitha kriteret, duke më trajtuar në mënyrë të pabarabartë me personat e tjerë të emëruar në këto pozicione, duke më diskriminuar për shkak të bindjeve politike”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të

drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjendjen arsimore dhe vendbanimin, të pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues (neni 1³). Neni 3, i këtij ligji, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 235, datë 17.12.2021, të bërë nga V.K, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1721/2, datë 29.12.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Bashkia Klos, për ankesën e bërë nga V.K si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të dosjes personale të ish-punonjësit V.K (emërimi, konfirmimi i statusit të nëpunësit civil, vlerësimit të punës, masa disiplinore, etj).
 - Kopje të procedurës së shpalljes për lëvizje paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet e punës: Përgjegjës i Sektorit të Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Përgjegjës i Zyrës së Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, mënyrën e dorëzimit të aplikimit dhe kopje të dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët.
 - Kopje të procedurës së vlerësimit të aplikimit të V.K për këto pozicione dhe kopje të ankesave dhe përgjigjeve të kthyer nga Bashkia Klos.
 - Kopje të vendimit të ngritjes së komisionit për vlerësimin e aplikimeve për këto pozicione.

³ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

- Kopje të plotë të dosjes personale të punonjësës I.K dhe procedurës së konkurimit dhe vlerësimit për pozicionin, Përgjegjës i Sektorit të Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, kopje të akteve.

Me shkresën nr. 3242/1, datë 06.01.2022, Bashkia Klos, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Siç edhe ju kemi informuar me detaje përmes shkresës nr. 104/1, datë 29.01.2021, ju sqarojmë përsëri se, V.K ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Klos dhe është emëruar për herë të parë pranë Bashkisë Klos me Vendimin nr. 37, datë 17.05.2017 “Për emërim të përkohshëm punonjësi”, në pozicionin Përgjegjës i Auditit të Brendshëm në Sektorin e Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Klos, duke vijuar me ushtrimin e detyrës në këtë pozicion deri me datë 15.11.2019, datë në të cilën, bazuar në kërkesën e tij nr. 2607, datë 11.11.2019, me objekt “Kërkesë”, është marrë Vendimi nr. 122, datë 15.11.2019 “Për lirim nga detyra”, është liruar nga detyra e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm. Me datë 26.05.2021, nga bashkia, ndër të tjera, janë shpallur për konkurrim pozicionet e lira të punës “Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Klos” dhe “Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos”, ku për të dyja këto pozicione ka shprehur interesin e tij, duke aplikuar edhe V.K, përmes paraqitjes së kërkesave përkatëse për aplikim. Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se V.K nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar në fazën e dytë të konkurimit, pasi nuk është nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë paraardhëse, një nga kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e ngritjes në detyrë dhe në dosjen e tij kishte mangësi në dokumentacionin e dorëzuar, si më poshtë:*

- Mungon jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me linkun: <http://dap.gov.al/vende•vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>, dokument i nevojshëm për aplikim i listuar në shpalljen për konkurrim.
- Mungon vërtetimi i gjendjes gjyqësore dhe vërtetimi i gjendjes shëndetësore, dokumente të nevojshëm për aplikim të listuar në shpalljen për konkurrim.

Sa më lart, pretendimi i ankuesit se vendimi për skualifikimin e tij nga procedura e konkurimit është bërë për arsye të diskriminimit për shkak të bindjes politike dhe se skualifikimi i tij nga procedura e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë si “Përgjegjës i Arsimit” ka pasur si qëllim emërimin në këtë pozicion pune të I.K, nuk qëndron dhe nuk është i drejtë. Për më tepër, ne nuk kemi qenë dhe nuk jemi në dijeni që ankuesi është anëtar i ndonjë subjekti politik. Po ashtu, nuk është aspak i vërtetë pretendimi i ankuesit që anëtarët e komisionit kanë pasur udhëzim për diskriminim nga titullari i institucionit për të për zgjedhur kandidaten e shpallur fituese, pasi Komisioni i ngritur në fillim të çdo viti kalendarik, ashtu siç parashikohet në dispozitat ligjore përkatëse, është i pavarur në vlerësimin e tij. Sa i përket pretendimit të ankuesit, që lidhet me shkresën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk qëndron, pasi është ezauruar rregullimi i ligjshmërisë për secilin rast, konform ligjit dhe V.K është liruar nga detyra me dëshirën dhe vullnetin e tij të lirë. Ne si institucion, nuk kemi detyrimin që të njoftojmë

kandidatët për pozicionet e lira të punës që bëhen shpallje nga ana jonë, pasi kushdo që është i interesuar i gjen ata fare lehtë në faqen zyrtare të bashkisë, në këndin e afishimeve publike, në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Ju informojmë se ankuesi në lidhje me këtë çështje e ka ndjekur edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të cilën gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë së V.K”.

Me shkresën datë 17.02.2022, subjekti ankues ka kundërshtuar informacionin e Bashkisë Klos, dhe në mes të tjerash ka informuar se: *“Bashkia Klos prej kohësh kishte punësuar “de fakto” në këtë pozicion pune edhe pse jo “de jure”, kandidaten I.K, e cila tashmë është emëruar në pozicionin e përgjegjës së arsimit. Bashkia Klos më ka skualifikuar nga procedura e lëvizjes paralele, e ngritjes në detyrë, pasi kandidatja e cila është shpallur fituese, nuk plotësonte kriteret e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pasi nuk ka qenë nëpunëse civile me status. Pozicioni i punës i saj i mëparshëm ka qenë punonjëse e bibliotekës në Bashkinë Klos. Rezulton se emërimi në detyrën e përgjegjës së arsimit, është bërë nga jashtë shërbimit civil, të kandidatës I.K, nga njësia e burimeve njerëzore. Kryetari i Bashkisë Klos është përfaqësues i Partisë Socialiste. Gjithashtu në zgjedhjet e vitit 2021, unë kam qenë komisioner i Komisionit Zonal nr. 17, Klos, ku kam përfaqësuar subjektin politik PD. Kandidatja e shpallur fituese ka qenë anëtare e komisionit të votimit në zgjedhjet e vitit 2021, si përfaqësuese e PS. Gjithashtu anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe ato të ngritjes në detyrë janë anëtarë të PS, ku Drejtori i burimeve njerëzore dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë qenë përfaqësues i PS në komisionet e zgjedhjeve të vitit 2021”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 235, datë 17.12.2021, Komisioneri me shkresën nr. 424, datë 07.03.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 16.03.2022, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm përfaqësuesi me autorizim⁴ i Bashkisë Klos, z. A.G. Subjekti ankues, përmes e-mail-it datë 13.03.2022, ka njoftuar se për arsye shëndetësore nuk mund të marrë pjesë në seancë, por ka dorëzuar parashtrime me shkrim.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i Bashkisë Klos deklaroi se kërkonte kohë për të përgatitur informacionin dhe dokumentacionin për procedurat e konkurimit për pozicionet e punës, Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos.

⁴ Autorizim nr. 712, datë 15.03.2022 i Bashkisë Klos.

Në vijim të detyrave të lëna, gjatë seancës dëgjimore, Bashkia Klos me e-mail-in datë 30.03.2022, dërgoi të skanuar dokumentacionin e kërkuar.

Ankuesi me e-mail-in datë 12.05.2022, ka dërguar shpjegime shtesë dhe në mes të tjerash ka pretenduar diskriminim dhe për shkak të gjendjes arsimore, gjatë procesit të konkurimit për pozicionet e sipërcituara. Ankuesi pretendon se: *“Jam diskriminuar për shkak të “gjendjes arsimore” pasi jam nënshtruar një trajtimi diferencues dhe më pak të favorshëm gjatë ushtrimit të së drejtës për punësim dhe ushtrimit të profesionit për shkak të nivelit të diplomës universitare. Unë ankuesi jam skualifikuar nga konkurimi, pasi unë zotëroj, diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare (diplomë master), kusht ky që kërkohet për të ushtruar profesionin dhe kandidati fitues nuk zotëron diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare”*.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të pabarabartë, për lirim nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, në datë 15.11.2019, bazuar në shkresën e KMSHC-së nr. 1625/2, datë 03.11.2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

V.K me ankesën nr. 159, datë 29.12.2020, drejtuar KMD-së, ka pretenduar diskriminim lidhur me procedurat e ndjekura nga Bashkia Klos, gjatë ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nga pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, dhe se pavarësisht se janë krijuar vende të lira pune për pozicionin që ai ka patur, si “Auditues i brendshëm”, atij nuk i është ofruar asnjë vend pune dhe as nuk është kaluar në listë pritjeje për një periudhë dy vjeçare.

Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankuesi janë shqyrtuar nga KMD, në kuadër të ankesës së mësipërme, për të cilën Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur me Vendimin nr. 27 datë 16.02.2021, në të cilin ka vendosur: *“Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 159 Regj., datë 29.12.2020, të paraqitur nga V.K, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë”*.

Vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga ankuesi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimin nr. 1736 datë 04.06.2021 ka vendosur: *“Pranimin e kërkesë padisë dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionerit”*.

Për sa më sipër, Komisioneri, bazuar në nenin 33, pika 4/c e LMD-së, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se ky pretendim i ankuesit për diskriminim nga ana e Bashkisë Klos, nuk mund të pranohen për shqyrtim.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushet kriteri ligjor për pranimin e pretendimit për largimin nga pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Auditit të Brendshëm, por do ndjekë procedurat ligjore lidhur me pretendimin për procedurat e konkurimit për pozicionet e “Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Klos” dhe “Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos” të shpallur nga bashkia me datë 26.05.2021.

B. Lidhur me trajtimin e padrejtë e të pafavorshëm, gjatë procedurave të konkurimit për pozicionet e “Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Klos” dhe “Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos”.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar raportit datë 31.03.2017, të Komitetit të Përhershëm të Pranimi të Bashkisë Klos, për rezultatin përfundimtar të procedurës së pranimi në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil për pozicionin: “Specialist auditi në Sektorin e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Klos”, rezulton se ankuesi është kandidati fitues për pozicionin e specialistit. Referuar Deklaratës datë 21.04.2017 të plotësuar nga ankuesi, rezulton se ai nuk ka zgjedhur pozicionin e specialistit të auditit, duke qëndruar në listën fituese për dy vite, pra deri në datë 21.04.2019.

Me Vendimin nr. 37, datë 17.05.2017 të Bashkisë Klos, është emëruar përkohësisht në pozicionin e “Përgjegjës të Auditit të Brendshëm” deri në përfundimin e procedurave të konkurimit për shkak të vakancës.

Me datë 01.11.2019 ankuesi ka paraqitur kërkesë për miratimin e dorëheqjes nga detyra e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm. Në vijim, Bashkia Klos shkresën nr. 2674, datë 15.11.2019 ka vendosur: “Të lirojë nga detyra e “Përgjegjës të Sektorit të Auditit të Brendshëm”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm Bashkia Klos, V.K sipas kërkesës së tij me nr. 2607, datë 11.11.2019”.

Referuar dokumentacionit të dërguar, rezulton se ankuesi është i diplomuar⁵ nga Universiteti i Shkodrës, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, në degën Histori-Gjeografi dhe në Fakultetin e Drejtësisë, në degën Juridik. Ankuesi zotëron dhe titullin Postmaster në Shkencat Administrative, të dhënë nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të Universitetit “Albanian University”. Gjithashtu ankuesi ka titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr.regjistri. 2001, datë 05.07.2019.

Me Urdhërin nr. 35, datë 24.02.2021, Bashkia Klos ka urdhëruar ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimi të nëpunësve civilë në kategorinë ekzekutive.

⁵ Diploma nr. 140, nr. Regjistri 985, datë 10.07.1991 dhe Diploma nr. 194/B, datë 27.02.1999.

Me Urdhërin nr. 74, datë 24.05.2021, Bashkia Klos ka urdhëruar ndër të tjera, shpalljen për konkurim për pozicionet e shërbimit civil për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë e ulët dhe atë ekzekutive për: 1 (një) Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Klos; dhe 1 (një) Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos.

Me shkresën nr. 1289, datë 26.05.2021, Bashkia Klos ka njoftuar shpalljen e vendeve të lira të punës në portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” për pozicionet e sipërcituara.

- Lidhur me konkurimin për pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Klos.

Sipas njoftimit publik, për pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Klos-Kategoria e pagës III-a/1, citohej se: Lloji i diplomës “Shkenca të Mësuesisë/Shkenca Sociale”, titulli minimal i diplomës “Master Profesional”, dhe “Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjen në detyrë dhe pranim nga jashtë në shërbimin civil”. Afati për dorëzimin e dokumenteve për lëvizje paralele është data 04.06.2021, dhe afati për dorëzimin e dokumenteve për ngritje në detyrë dhe aplikim nga jashtë shërbimit civil, është data 09.06.2021.

Në pikën 1.1 të publikimit për vendin vakant, janë vendosur kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta, si më poshtë: “Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë Diplomë “Master Profesional” në Shkencat Mësuesisë/Shkenca Sociale.
- b. Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune.....

Në pikën 2 të njoftimit “Ngritja në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil” është përcaktuar se: “Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil”.

Në pikën 2.1 të publikimit, janë vendosur kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta, si më poshtë: “Kandidati duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:

- a. Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Në pikën 2.3 të publikimit, janë vendosur dokumentacionet që duhet të dorëzonin kandidatët, si më poshtë: “Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë”:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- b. Fotokopje e diplomës;
- c. Fotokopje e librezës së punës;
- d. Fotokopje të letërnjoftimit;
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 09.06.2021, në Bashkinë Klos.

Referuar Kartelës Shoqëruese të Praktikës, të protokolluar nga Bashkia Klos me nr. 1411, datë 07.06.2021, rezulton se ankuesi në datë 07.06.2021 ka dorëzuar kërkesën për konkurim dhe dokumentacionin për pozicionin e Përgjegjësit në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar rezulton se Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, nëpërmjet njoftimit (e-mail datë 14.06.2021) për fazën e verifikimit paraprak të ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil në kategorinë e ulët drejtuese, ka njoftuar aplikantët si më poshtë:

1. V.K njoftohet se nuk është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin e Përgjegjësit në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj rezultoi:

- a. Ju nuk jeni nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë paraardhëse. Një nga kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e ngritjes në detyrë.
- b. Në dosjen tuaj nuk keni bashkëlidhur jetëshkrimin e plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>; dokument i nevojshëm për aplikim, i listuar në shpalljen për konkurim.
- c. Në dosjen tuaj mungon vërtetimi i gjendjes shëndetësore dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore, dokumenta të nevojshëm për aplikim, të listuar në shpalljen për konkurim.

Ju keni të drejtë të paraqisni ankesë me shkrim pranë Bashkisë Klos, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së kandidatëve të cilët janë paraseleksionuar për pozicionin e mësipërm.

Në Kreu III, pika 26 të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, përcaktohet se: “Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 25 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit”.

Në vijim ankuesi pasi është vënë në dijeni të rezultatit të aplikimit të tij, me shkresën e protokolluar pranë Bashkisë Klos, me nr. 1411/1, datë 21.06.2021, është ankuar lidhur me skualifikimin e tij dhe ka bashkëlidhur dhe kopje të provave për pretendimet e tij.

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) të Bashkisë Klos me shkresën nr. 1411/2, datë 22.06.2021, i ka kthyer përgjigje ankuesit, në të cilën në mes të tjerash e ka informuar se: “NJMBNJ pranë Bashkisë Klos mori dhe njëherë në shqyrtim dosjen tuaj së bashku me dokumentacionin plotësues. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Ju nuk keni bashkëlidhur dokumentin që vërteton se jeni nëpunës civil i konfirmuar, vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore, dokumenta të nevojshëm për aplikim, të listuar në shpalljen për konkurim. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Admistrative të Shkollës së Parë”.

2. A.D njoftohet se nuk është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së pranimit në shërbimin civil për pozicionin e Përgjegjësit në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj rezultoi:

- a. Në dosjen tuaj nuk keni bashkëlidhur jetëshkrimin e plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>; dokument i nevojshëm për aplikim, i listuar në shpalljen për konkurim.
- b. Në dosjen tuaj mungon librezja e punës. Mungesa e librezës së punës në këtë rast ju skualifikon.

3. E.N njoftohet se nuk është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së pranimit në shërbimin civil për pozicionin e Përgjegjësit në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj rezultoi:

- a. Ju nuk plotësoni kriterin minimal të diplomës, i cili për këtë pozicion është “Master Profesional”. Një nga kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion është të zotërojë diplomë “Master profesional”.

4. I.K dhe N.D njoftohen se janë kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil për pozicionin e Përgjegjësit në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datë 25.06.2021.

Referuar Raportit datë 01.07.2021 të Komitetit të Përhershëm të Pranimit të Bashkisë Klos, rezulton se kandidati I.K është renditur fitues me 71.4 pikë, ndërsa kandidati N.D është renditur jofitues me 42.8 pikë.

Me aktin e emërimit nr. 1837, datë 19.07.2021, I.K është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin, Përgjegjëse në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Referuar nenit 26, pika 3, gërmat a) dhe b), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për procedurën “Lëvizje paralele” kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil, ndërkohë që për procedurën “Ngritje në detyrë” kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Në nenin 22, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohet:

1. *Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur.*
2. *Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
3. *Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza:*
 - a) *verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;*
 - b) *vlerësimi i kandidatëve.*
4. *Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimit, i krijuar për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
5. *Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimit, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm.....”.*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ankuesi ka konkuruar për pozicionin e sipërcituar për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil, pasi ka dorëzuar dokumentacionin në datë 07.05.2021, ndërkohë që afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele ka qenë në datë 04.06.2021.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se ankuesi nuk zotëron një dokument që të vërtetojë se është nëpunës civil i konfirmuar për periudhën kur ka aplikuar për pozicionet e

sipërcituara, si dhe nuk ka dorëzuar vërtetimin për gjendjen shëndetësore dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se NJMBNJ e Bashkisë Klos ka ndjekur të njëjtën procedurë dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit, për të gjithë konkurentët për pozicionin e sipërcituar. Referuar njoftimeve për verifikimin paraprak të dosjeve, rezulton se NJMBNJ e Bashkisë Klos, përveç ankuesit ka skualifikuar dhe dy kandidatë të tjerë, A.D për mungesë dokumentacioni dhe E.N për mosplotësim të kriterit minimal të diplomës.

Referuar dokumentacionit dhe provave të administruara, rezulton që kandidatët I.K dhe N.D, kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas shpalljes së publikuar dhe plotësonin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vazhdimin e konkurimit për pozicionin e Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndërsa aplikuesit: V.K dhe A.D nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe E.N nuk plotësonte kriterin minimal të diplomës, dhe për këtë arsye nuk janë kualifikuar për të vazhduar konkurimin.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë shqyrtimit të kërkesa të përgjithshme dhe të veçanta për pozicionin e Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Bashkisë Klos-Kategoria e pagës III-a/1, ka konstatuar se bashkia në kriterin e arsimit ka kërkuar që kandidatët duhet të kenë: Lloji i diplomës “Shkenca të Mësuesisë/Shkenca Sociale”, titulli minimal i diplomës “Master Profesional”.

Në Lidhjen 2, pika 2/2, “Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe kërkesat për pranimin në çdo klasë”, Klasa III/1 dhe III/2, të VKM-së nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Klasa III/1. Në këtë klasë përfshihet shefi i sektorit dhe pozicione të barazvleshme me të..... Kërkesa të posaçme: Arsimit: Master Shkencor..... Klasa III/2. Në këtë klasë përfshihet shefi i sektorit, veprimtaria e të cilit është e fokusuar në zbatimin e drejtpërdrejtë të procedurave dhe standarteve të përcaktuara me ligj/akt nënligjor, ose të hartuara nga institucioni epror..... Kërkesa të posaçme: Arsimit: Master Shkencor....”.

Nga verifikimi njoftimit për pozicionin e punës të sipërcituar, rezulton se NJMBNJ e Bashkisë Klos, nuk ka respektuar kriterin e arsimit të kërkuar në legjislacionin e sipërcituar, i cili duhet të jetë “Master Shkencor”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të kandidatit të shpallur fitues, rezulton se I.K zotëron diplomë të nivelit “Master Profesional” të lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Në analizë të informacionit të analizuar më sipër, Komisioneri vëren se NJMBNJ e Bashkisë Klos, ka vendosur kriterin e arsimit në shkelle të parashikimit ligjor të VKM-së nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar. Pavarësisht faktit që

NJMBNJ e Bashkisë Klos, ka vendosur kriterin e arsimit në shkelje të legjislacionit, nuk vërehet një trajtim i padrejtë dhe i pabarabartë i ankuesit, pasi përmbushja e kriterëve ligjore për dorëzimin e plotë të dokumentacionit të kërkuar në shpalljen për pozicionin e punës, është një detyrim i parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në këtë kuptim, pretendimi i ankuesit për t'u kualifikuar për vazhdimin e procedurës së konkurimit, vjen në shkelje të akteve ligjore të sipërcituara dhe si i tillë nuk mund të legjitimohet nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

– *Lidhur me konkurimin për pozicionin Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos.*

Sipas njoftimit publik, për pozicionin Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, Bashkia Klos-Kategoria e pagës III-a/1, citohej se: Lloji i diplomës “Shkenca Juridike, Ekonomike dhe Inxhinieri Ndërtimi”, titulli minimal i diplomës “Master Shkencor”, dhe “*Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjen në detyrë dhe pranim nga jashtë në shërbimin civil*”. Afati për dorëzimin e dokumenteve për lëvizje paralele është data 04.06.2021, dhe afati për dorëzimin e dokumenteve për ngritje në detyrë dhe aplikim nga jashtë shërbimit civil është data 09.06.2021.

Në pikën 1.1 të publikimit për vendin vakant, janë vendosur kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta, si më poshtë: “*Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:*

- a. *Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;*
- b. *Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;*
- c. *Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.*

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. *Të zotërojë Diplomë “Master Shkencor” në Shkenca Juridike, Ekonomike dhe Inxhinieri Ndërtimi.*
- b. *Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune.....*

Në pikën 2 të njoftimit “*Ngritja në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil*” është përcaktuar se: “*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil*”.

Në pikën 2.1 të publikimit, janë vendosur kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta, si më poshtë: “*Kandidati duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:*

- a. *Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;*
- b. *Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;*

c. *Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.*

Në pikën 2.3 të publikimit, janë vendosur dokumentacionet që duhet të dorëzonin kandidatët, si më poshtë: *“Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë”:*

- a. *Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;*
- b. *Fotokopje e diplomës;*
- c. *Fotokopje e librezës së punës;*
- d. *Fotokopje të letërnjoftimit;*
- e. *Vërtetim të gjendjes shëndetësore;*
- f. *Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;*
- g. *Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;*
- h. *Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;*
- i. *Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.*

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 09.06.2021, në Bashkinë Klos.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ankuesi ka dorëzuar kërkesën për konkurim dhe dokumentacionin për pozicionin e Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar rezulton se NJMBNJ, nëpërmjet njoftimit (e-mail) për fazën e verifikimit paraprak të ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil në kategorinë e ulët drejtuese, ka njoftuar aplikantët si më poshtë:

1. V.K njoftohet se nuk është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin e Përgjegjës në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj rezultoi:

- a. *Ju nuk jeni nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë paraardhëse. Një nga kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e ngritjes në detyrë.*
- b. *Në dosjen tuaj nuk keni bashkëlidhur jetëshkrimin e plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>; dokument i nevojshëm për aplikim, i listuar në shpalljen për konkurim.*
- c. *Në dosjen tuaj mungon vërtetimi i gjendjes shëndetësore dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore, dokumenta të nevojshëm për aplikim, të listuar në shpalljen për konkurim.*

Ju keni të drejtë të paraqisni ankesë me shkrim pranë Bashkisë Klos, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së kandidatëve të cilët janë paraseleksionuar për pozicionin e mësipërm.

Në Kreu III, pika 26 të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, përcaktohet se: “Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 25 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit”.

Në vijim ankuesi pasi është vënë në dijeni të rezultatit të aplikimit të tij, me shkresën nr. 1411/1, datë 21.06.2021, është ankuar lidhur me skualifikimin e tij dhe ka bashkëlidhur dhe kopje të provave për pretendimet e tija.

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) të Bashkisë Klos me e-mail-in datë 22.06.2021, i ka kthyer përgjigje ankuesit, në të cilën në mes të tjerash e ka informuar se: “NJMBNJ pranë Bashkisë Klos mori dhe njëherë në shqyrtim dosjen tuaj së bashku me dokumentacionin plotësues. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: - Ju nuk keni bashkëlidhur dokumentin që vërteton se jeni nëpunës civil i konfirmuar, vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore, dokumenta të nevojshëm për aplikim, të listuar në shpalljen për konkurim. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Admistrative të Shkallës së Parë”.

2. N.D njoftohet se nuk është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së pranimit në shërbimin civil për pozicionin e Përgjegjësit në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj rezultoi:

- Ju nuk plotësoni kriterin e fushës së studimit në Shkenca Juridike, Ekonomike dhe Inxhinieri Ndërtimi.

3. Y.T njoftohet se nuk është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së pranimit në shërbimin civil për pozicionin e Përgjegjësit në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj rezultoi:

- Në dosjen tuaj nuk keni bashkëlidhur jetëshkrimin e plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>; dokument i nevojshëm për aplikim, i listuar në shpalljen për konkurim.

Pas shqyrtimit të ankesës së kandidatit Y.T dhe plotësimit të dokumentacionit, NJMBNJ pranë Bashkisë Klos, njoftoi kandidatin për kualifikimin e tij për në fazën e dytë të procedurës së pranimit.

4. D.M njoftohet se është kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil për pozicionin e Përgjegjësit në Zyrën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datë 25.06.2021.

Referuar Vendimit datë 01.07.2021 të Komitetit të Përhershëm të Pranimi të Bashkisë Klos, rezulton se komiteti ka vendosur përfundimin e fazës së vlerësimit pa asnjë kandidat të përzgjedhur fitues, pasi asnjë nga kandidatët nuk merr 70 pikë nga 100 të mundshme.

Me shkresën nr. 1803, datë 14.07.2021, Bashkia Klos ka njoftuar Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit se për pozicionin e Përgjegjës të Zyrës së Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, nuk ka kandidat fitues.

Referuar nenit 26, pika 3, gërmat a) dhe b), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për procedurën “Lëvizje paralele” kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil, ndërkohë që për procedurën “Ngritje në detyrë” kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Në nenin 22, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohet:

1. *Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur.*
2. *Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
3. *Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza:*
 - a. *verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;*
 - b. *vlerësimi i kandidatëve.*
4. *Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimi, i krijuar për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
5. *Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimi, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm.....”.*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ankuesi ka konkuruar për pozicionin e sipërcituar për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimi në shërbimin civil, pasi ka dorëzuar dokumentacionin në datë 07.05.2021.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se ankuesi nuk zotëron një dokument që të vërtetojë se është nëpunës civil i konfirmuar për periudhën kur ka aplikuar për pozicionin e sipërcituar, si dhe nuk ka dorëzuar vërtetimin për gjendjen shëndetësore dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se NJMBNJ e Bashkisë Klos ka ndjekur të njëjtën procedurë dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit, për të gjithë konkurentët për pozicionin e sipërcituar. Referuar njoftimeve për

verifikimin paraprak të dosjeve, rezulton se NJMBNJ e Bashkisë Klos, përveç ankuesit ka skualifikuar dhe kandidatin N.D sepse nuk plotësonte kriterin e fushës së studimit.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, rezultoi se ankuesi nuk ishte kualifikuar për të vijuar procedurën e mëtejshme të konkurimit për shkak të mosdorëzimit të dokumentacionit të kërkuar për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil për pozicionin e punës të sipërcituar dhe NJMBNJ ka mbajtur të njëjtin qëndrim në vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët, duke skualifikuar në fazën e parë dhe kandidatin Y.T, për mungesë të dorëzimit të dokumentacionit.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e NJMBNJ të Bashkisë Klos, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për vlerësimin e dokumentave të ankuesit dhe ankuesi ka pasur mundësi për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Ankuesi nuk është vendosur në kushte të pafavorshme nga ana e NJMBNJ të Bashkisë Klos, pasi kjo njësi ka mbajtur të njëjtin qëndrim për vlerësimin e dokumentacionit dhe për aplikuesit e tjerë për pozicionet e punës objekt i kësaj ankese.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1/a/b) të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se Bashkia Klos, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e Bashkisë Klos, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Bashkia Klos ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/a/b, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit V.K, nga ana e Bashkisë Klos, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA